



NEWSLETTER

Tetor 2024

Nr.10

Ditët e hapura të arsimit mediatic 2024



Nën moton "Vetëdija juaj është filtri më i rëndësishëm", duke filluar nga data 28 tetor deri më 4 nëntor, në organizimin e Rrjetit të arsimit mediatic, për të gjashtë herë u mbajtën Ditët e arsimit mediatic 2024. Pesëmbëdhjetë anëtarë të Rrjetit dhe mbështetësit e tyre organizuan 22 evente në lokacione të ndryshme në të gjithë shtetin, dhe disa prej tyre u mbajtën online. Në këtë mënyrë vendi ynë iu bashkua Javës Globale të arsimit dhe informimit mediatic të UNESCO. Në Konferencën "Politikat për arsimimin mediatic në epokën e inteligjencës artificiale", drejtori i ASHMA-së dr. Zoran Trajčevski, theksoi se "Ditët e arsimit mediatic janë evente më i rëndësishëm kombëtar për mobilizimin e qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile, entit arsimor, mediave dhe institucioneve shtetërore, si dhe ndërgjegjësimi i tyre për rëndësinë e arsimit mediatic. Fokusi këtë vit është tek inteligjenca artificiale, e cila tashmë është aq e pranishme, sa që menduam se duhet ta diskutojmë në mënyrë të pashmangshme pak më thellë".

Konferenca përfshiu tre panele, nga të cilat në panelin e parë u mbajt punëtorja "Inteligjenca artificiale dhe e drejta e autorit", me Dr. Hanes Henke, ekspert nga RF e Gjermanisë, i angazhuar përmes projektit Tving "Forcimi i kapaciteteve të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Shërbimit Publik Radiodifuziv". Paneli i dytë, organizuar nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, u diskutua për temën "Etika në përdorimin e inteligjencës artificiale", ndërsa paneli i fundit, "Politikat për zhvillimin e vetëdijes për rreziqet e dezinformimit", organizuar nga Instituti i Kërkimeve për Zhvillimin Social RESIS, u prezantuan gjetjet krahasuese nga Monitori i pluralizmit mediatic në epokën digjitale (MPM 2024), mbi treguesit e arsimit mediatic dhe mbrojtjes nga keqinformimi.

Për nevojat e Ditëve të arsimit mediatic 2024, u përgatitën video dhe audio spot në gjuhën maqedonase, shqip dhe anglisht. Spotet janë transmetuar në media me qëllim për të informuar një numër më të madh të qytetarëve për eventet e arsimit mediatic. Më shumë informacion për eventet që u mbajtën në kuadër të Ditëve mund të gjeni në ueb-faqet mediumskapismenost.mk dhe avmu.mk dhe në Facebook, Instagram dhe kanalin YouTube të Rrjetit për arsimimin mediatic.

Njoftim publik

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale më 25 tetor, dënoi ashpër djegien e automjetit të pronarit të televizionit rajonal M-Net HD nga Shtipi Blagoj Sersemov, nga autorë të panjohur në oborrin e shtëpisë së familjes.

Në njoftim është theksuar se kërcënimet dhe frikësimet drejtuar mediave minojnë demokracinë, lirinë e fjalës dhe lirinë e informimit. Siguria e punonjësve të medias është thelbësore për ekzistencën e mediave të pavarura dhe profesionale, të cilat janë një nga shtyllat kryesore të proceseve demokratike dhe që kontribuojnë në avancimin e lirisë së shprehjes. Agjencia i bëri apel Ministrisë së Punëve të Brendshme që rasti të zbardhet sa më shpejt dhe të informojë opinionin për arsytet që kanë çuar në këtë akt vandal.

Konkurset publikë për dhënie e lejeve për transmetim në radio

Në seancën e 39-të mbajtur më 17 tetor, Këshilli i Agjencisë miratoi Vendim për shpalljen e Konkursit publik për dhënie e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës. Aplikacioni për pjesëmarrje në Konkursin publik mund të shkarkohet në [linkun](#) e mëposhtëm. Afati i fundit për paraqitjen e aplikimeve për Konkursin publik është deri më 30.12.2024 (e hënë).

Në seancën e 38-të mbajtur më 9 tetor, Këshilli i Agjencisë miratoi Vendim për shpalljen e Konkursit publik për dhënie e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e Komunës së Manastirit. Aplikacioni për pjesëmarrje në Konkursin publik për dhënie e lejes për transmetim në radio mund të shkarkohet në [linkun](#) e mëposhtëm. Afati i fundit për paraqitjen e aplikimeve për Konkursin publik është deri më 16.12.2024 (e hënë).

Më shumë informacion në lidhje me dokumentacionin e konkursit për dy konkurset publike mund t'i gjendi në ueb-faqen e ASHMA-së në [link](#).



NEWSLETTER

Mbikëqyrja e transmetuesve, operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik dhe medias së shkruar

Transmetuesit

Mbikëqyrje e rregullt programore për disa detyrime ligjore - respektimi i rregullave gjatë transmetimit të komunikimeve komerciale audiovizuele, mbrojtja e të miturve nga programe që mund të dëmtojnë zhvillimin e tyre fizik, mendor ose moral, mbrojtja e të dhënave personale të të miturve, ofrimi i kuizeve ose forma të tjera të pjesëmarrjes në lojëra shpërblyese, përdorimi i shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar dhe votimi telefonik, transmetimi i lojërave të fatit, përdorimi i gjuhës në programe, transmetimi ditor së paku 12 orë program në televizion dhe transmetimi ditor së paku 30% program fillimisht burimor si vepra audio maqedonase ose vepra audiovizuele, mbikëqyrja e rregullt programore është kryer mbi televizionet - TV Alfa, TV Alsat-M, TV Kanal 5, TV Nasha, TV Shenja, TV Telma, TV 21- M, TV 24 Vesti, TV Klan Maqedoni, TV Sitel dhe TV Sonce.

Gjatë mbikëqyrjes është konstatuar se TV Shenja, TV 21-M dhe TV Sitel transmetonin programe me aplikim të gabuar të sinjaleve paralajmëruese për programet e kategorisë së dytë (8+); TV Shenja më 11 shtator, nuk ka transmetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase dhe as nuk ka transmetuar së paku gjysmën e minimumit ligjor program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase në periudhën prej orës 07:00 deri në orën 19:00; ndërsa në programin e TV Kompani 21-M më 10 shtator në emisionin "Pastel", deklarata e bashkëbiseduesit është transmetuar fillimisht në gjuhën serbe, pa ofruar përkthim në gjuhën shqipe apo maqedonase.

Mbi të njëjtat televizione është kryer dhe mbikëqyrje e rregullt administrative për detyrimet për publikim impresium, informacioni që duhet të vihet në dispozicion të përdoruesve dhe për publikimin e identifikimit të transmetuesit. Gjatë mbikëqyrjes nuk janë konstatuar shkelje.

Mbikëqyrje e rregullt administrative për përmbushjen e kushteve minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio është kryer mbi 53 transmetues. Mbikëqyrja rezultoi se transmetuesit e kanë përmbushur detyrimin e Rregullores.

Pas detyrës zyrtare është kryer mbikëqyrje e jashtëzakonshme administrative mbi punën e radio RRAPI nga Struga për të konstatuar nëse transmetuesi ka kryer ndryshimin e strukturës së pronësisë pa e njoftuar më parë Agjencinë dhe para se ndryshimi të miratohej nga Agjencia. Me mbikëqyrjen e jashtëzakonshme është konstatuar se transmetuesi, në kundërshtim me LSHMAAV, më 1 tetor ka zbatuar ndryshimin e strukturës së pronësisë pa e njoftuar më parë Agjencinë dhe pa u miratuar nga Agjencia.

Mbi TV Gurra nga Kërçova është kryer mbikëqyrje e kontrollit programor për detyrimin e zbatimit të konceptit programor për të cilin është dhënë leja. Gjatë mbikëqyrjes mbi shërbimin programor të transmetuar në periudhën prej datës 16 deri më 22 shtator është konstatuar se transmetuesi nuk ka vepruar sipas aktvendimit për shqiptimin e masës-vërejtje publike, përkatësisht nuk ka zbatuar së paku 80% të konceptin programor për të cilin është dhënë leja për transmetim televiziv, që është detyrim nga neni 67 paragrafi 6 i LSHMAAV.

Operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik

Mbikëqyrja e rregullt programore është kryer mbi operatorët Spajder, MTEL, Nafi dhe Beko, Drim Sat IPTV dhe Total TV për respektimin e detyrimeve për regjistrimin e shërbimeve programore dhe titrimin e shërbimeve programore që ritransmetojnë. Gjatë mbikëqyrjes është konstatua se disa operatorë kanë ritransmetuar shërbime programore që nuk mbulohej me certifikatën për regjistrim të shërbimit programor dhënë nga Agjencia për secilin operator në veçanti. Operatori MTEL më 16 tetor ritransmetoi shërbimet programore "Telma", "Alfa TV", "Kanal 5", "Alsat M", "Kompani 21", "24 Vesti", "News Max Balkans", "Diva", "Nickelodeon", "Nickelodeon Junior", "RTL", "RTL II" dhe "RTL Croatia"; operatorët Nafi dhe Beko më 17 tetor ritransmetuan shërbimin programor "TV Kanal 5"; operatori Drim Sat IPTV më 17 tetor ritransmetoi shërbimin programor "Hit Mix Music"; ndërsa operatori Total TV më 14 tetor ritransmetoi për përdoruesit e tij shërbimet programore "Sky News", "Brazzers", "Reality Kings", "CNN" dhe "Narodna".

Mbikëqyrja e rregullt programore mbi operatorët Mtel, Nafi dhe Beko dhe Drim Sat IPTV është kryer dhe për respektimin e detyrimit në paketën programore që ritransmetojnë detyrimisht dhe pa pagesë për të ofruar shërbimet programore të Shërbimit Publik Radiodifuziv. Nga mbikëqyrja është konstatuar se operatorët kabllorë kanë vepruar në përputhje me dispozitën ligjore të nenit 143 paragrafi 3 të LSHMAAV.

Është realizuar dhe një mbikëqyrje e kontrollit programor mbi operatorin A1 Maqedoni, për të konstatuar nëse operatori ka vepruar sipas masës vërejtje publike drejtuar për qëllim të ritransmetimit të shërbimeve programore që nuk janë të regjistruara në Agjenci. Me mbikëqyrjen u konstatua se operatori për përdoruesit e tij ka ritransmetuar shërbimin programor "Tring Sport News", i cili nuk mbulohet me certifikatë për regjistrim të shërbimeve programore dhënë nga Agjencia.



NEWSLETTER

Media e shkruar

Sa i përket botuesve të medias së shkruar Media Pres VM botues i "Bitolski Vesnik", Agjencia, KAPITAL MEDIA GROUP botues i "Kapital"; JENI BALKAN botues i "Bahçes"; ANTIQ MEDIA botues i "Portret"; MEDIUM BOJA 43 botues i "Shtipski glas"; KOLOR MEDIA PLUS botues i "Ubavina i zdravje"; VIZIONI M botues i "Shenja"; ZENIT PRESS PLUS botues i "Zenit"; KLIKER MARKETING botues i "InStore"; dhe NARODEN LEKAR botues i "Naroden lekar", Repro Print botues i "Nova Makedonija"; Sloboden Peçat, botues i "Sloboden Peçat"; Veçer Press, botues i "Veçer"; Koha Production botues i "Koha"; Media Plus Fokus botues i "Fokus"; ATV Media Kompani botues i "Lajm"; Euro-Mak Kompani botues i "Ekonomija i biznes"; Byroja Pres botues i "Porta 3" dhe Pablik botues i "Lice v lice", Agjencia realizoi mbikëqyrje të rregullt administrative për detyrimet për publikim impresium, të dhëna për selinë, shtypshkronjën, datën e shtypjes ose ribotimit dhe numrin e kopjeve të botuara (shtypura), detyrime sipas Ligjit për media. Nga mbikëqyrja u konstatua se media e shkruar e përmbush plotësisht detyrimin ligjor.

Masat e shqiptuara vërejtje publike

Në lidhje me konstatimet nga mbikëqyrja e rregullt programore, Këshilli i Agjencisë në seancën e 40-të mbajtur më 24 tetor për operatorët Drim Sat IPTV, Nafi dhe Beko dhe Mtel ka miratuar vendime për paralajmërim publik dhe për përjashtimin e ritransmetimit të shërbimeve programore që nuk mbulohen me certifikatën për regjistrim të shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia. Masë paralajmërim publik është shqiptuar ndaj Drim Sat IPTV për ritransmetimin e shërbimit programor "Hit Mix Music", Nafi dhe Beko për ritransmetimin e shërbimit programor "TV Kanal 5", ndërsa MTEL për ritransmetimin e shërbimeve programore "Telma", "Alfa TV", "Kanal 5", "Alsat M", "Kompania 21", "24 Vesti", "News Max Balkans", "Diva", "Nickelodeon", "Nickelodeon Junior", "RTL", "RTL II" dhe "RTL Kroaci".

Këshilli i Agjencisë në seancën e 38-të mbajtur më 9 tetor, në bazë të konstatimeve nga mbikëqyrja e rregullt programore ndaj radio Zona M-1, shqiptoi masë paralajmërim publik për ritransmetimin së paku 30% muzikë në gjuhën maqedonase në periudhën nga ora 06:00 deri në orën 00:00, nga totali i muzikës së transmetuar në ditë-natën e analizuar.

